



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:253571
Datë: 16.05.2023
Numri i dokumentit: 04284616
C.nr.102/2021

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të *paditësit* B. (V...) B nga fshati ..., Kaçanik, të cilin e përfaqëson Sabri Kryeziu –avokat nga Lipjani , kundër të paditurit Komuna e Kaçanikut, të cilin me autorizim e përfaqëson Ilir Lumi nga Kaçaniku, për çështjen vërtetimin e pronësisë , në seancën kryesore të mbajtur me datën 16.05.2023, në mungesën e palëve ndërgjyqës , dhe po në të njëjtën ditë, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit B.(V...) B nga fshati ..., Kaçanik e ushtruar më datën 29.08.2013, kundër të paditurit Komuna e Kaçanikut, për çështjen kontestuese kthimin ne posedim dhe shfrytëzim te paluajtshmerisë, konsiderohet si e TËRHEQUR.

II. DETYROHET pala paditëse qe kësaj gjykate te i'a paguajë shumën prej 30.00€, në emër të taksës për padi, e cila pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit më datën 29.08.2013, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka ushtruar Padi kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut, me të cilën ka kërkuar ta vërtetojë se paditësi është pronare i një pjese te parcelës kadastrale ... ne sipërfaqe te përgjithshme 1406 m2 e evidentuar ne Certifikatën pronësore me numër te lendes ..., si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata për datën 16.05.2023, e ka caktuar seancën kryesore i ka ftuar palët ndërgjyqëse, te cilin fakt gjykata e ka vërtetuar nga fletë kthesat te cilat gjinden ne shkresat e lendes te datës 20.04.2023 , nga e cila vërtetohet se pala paditëse është ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar në seancën kryesore, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës kryesore.

Ndërsa pala e paditure ka prezantuar ne seancën gjyqësore dhe i ka propozuar gjykatës qe padinë e paditësit ta konsideroj te tërhequr sepse pala paditëse është ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata padinë e paditësit e konsideroj të tërhequr sepse pala paditëse, është ftuar në mënyrën e paraparë ligjore, e njëjta nuk ka prezantuar në seancën kryesore, mungesën nuk e ka arsyetuar, nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës kryesore. Prandaj gjykata veprimi konform nenit 423.3 të LPK-së, e me të cilën dispozitë është e paraparë në qoftë se në seancën kryesore nuk vjen pala paditëse edhe pse është ftuar rregullisht konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Me dispozitën e cekur më lartë është paraparë pasoja e mungesës së palës në seancën kryesore. Kështu mungesa e paditësit në seancën kryesore e tërheq në vete presumcionin e tërheqjes së padisë. Prandaj për tu konsideruar si e tërhequr padia duhet të plotësohen kushtet edhe atë mungesa e paditësit në procedurë, ftesa ti jetë bërë me rregull dhe mungesa të mos jetë arsyetuar. Se pala paditëse është ftuar me rregull, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga fletë kthesa postare e datës 20.04.2023, nga e cila vërtetohet se i autorizuari i paditësit është ftuar me rregull për seancën kryesore.

Përcaktimi i ligdhënësit për një zgjedhje të tillë duhet kërkuar në faktin se procedura kontestimore inicohet, me vullnetin ekskluziv të palës paditëse, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e paditësit në procedurë nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Përveç kësaj është në interesin e paditësit, që procedura të përfundoj në afat sa më të shkurtë, prandaj sjellja pasive e paditësit, në raport me kontestin është tregues, se paditësi e ka humbur interesin për vazhdimin e më tejme të kontestit .

Prandaj gjykata duke marrë parasysh të cekurat më lartë, ka zbatuar dispozitën e nenit 423.3 të LPK-së, duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditëses, sepse paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk kanë kërkuar shtyrjen e seancës kryesore, e këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga fletë kthesa e datës 20.04.2023.

Gjykata e detyroi palën paditëse që ta paguaj shumën prej 30.00€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë ashtu si është paraparë me nenin 253.4 të LPK-së. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve të tjera të krijuara nga palët ndërgjyqës secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,

Dega në Kaçanik

C.nr.102/2021 prej datës 16.05.2023

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar palëve me datë 16.05.2023

Paditësit 1 x 1

Të paditurit 1 x 1